



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 42
Prishtinë, më 15 nëntor 2012, në orën 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P r o c e s v e r b a l

Nga takimi i Komisionit për Punë të Jashtme me delegacionin nga Egjipti

Delegacioni nga Këshilli Shura (Dhoma e Lartë-Këshilli Konsultativ) i Egjiptit ishte në këtë përbërje: z. Ahmed Fahmy Ahmed, kryetar i Këshillit Shura (Dhoma e Lartë - Këshilli Konsultativ), z. Mohamed Mohamed Mahsoub, Ministër për çështje ligjore dhe këshilla parlamentare, z. Aly Sayd Fath El-Bab, Komisioni për Industri dhe Energji, z. Abdullah Abd El-Azziz Mohamed Badran, nga Komisioni për çështje arabe dhe të jashtme dhe siguri kombëtare, z. Mohamed El Hanafi El Sayed Abou Elenin, nga Komisioni për çështje kushtetuese dhe ligjore, z. Taher Abdel Mohsen Ahmed Suleiman, nga Komisioni për çështje kushtetuese dhe ligjore, z. El Sayed Ibrahim el Sayed Salah, nga Komisioni për çështje financiare dhe ekonomike, z. Hassan Yousef Abdel Ghaffar Gaber, nga Komisioni për shëndetësisë dhe çështje të mjedisit, z. Mohamed Mohammed Suleiman Shlof, nga Komisioni për prodhim bujqësor, ujitje dhe bonifikimin e tokave, z. Osama Fakri Sad Fadel, nga Komisioni për shëndetësi dhe çështje të mjedisit, z. Mohamed Ahmed Ahmed Elazab, nga Komisioni për Drejtat e Njeriut.

Në takim morën pjesë: z. Albin Kurti, z. Skender Hyseni, znj. Donika Kadaj- Bujupi, znj. Emilija Rexhepi dhe z. Beqir Ismaili përfaqësues i institucioneve të Republikës së Kosovës në Egjipt.

Pjesëmarrës të tjerë: Blerim Dervishi dhe Besarta Zuka- NDI.

Nga zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Takimin e kryesoi: Albin Kurti - kryetar i Komisionit.

R e n d d i t e:

Takim i Komisionit me delegacionin nga Këshilli Shura (Dhoma e Lartë-Këshilli Konsultativ)

Albin Kurti fillimisht i dëshiroi mirëseardhje parlamentarëve egjiptian. Njoftoi se shteti i Kosovës, si shtet i ri, është njohur nga më se gjysma e shteteve, por jemi të interesuar që të njihet nga sa më

shumë shtete dhe të vihen kontaktet e bashkëpunimit me to. Përgëzoi popullin e Egjiptit për triumfin e revolucionit demokratik "Pranvera Arabe" për të cilin theksoi se është një dëshmi se diktaturat mund të zgjasin, por se një ditë përfundojnë dhe këputen. Ndër sfidat e Kosovës, përveç njohjes ndërkombëtare, theksoi problemin e zhvillimit ekonomik, problemin e qytetit të ndarë të Mitrovicës, ku gjysma e qytetit dhe çereku i territorit të Kosovës kontrollohen nga strukturat paralele ilegale të Serbisë. Ai, po ashtu, e njoftoi delegacionin për humbjet e mëdha që ka pasur Kosova gjatë luftës së fundit, për procesin e privatizimit dhe bisedimet me Serbinë. Egjipti tha se është një shtet i rëndësishëm, i lashtë, me pozitë të jashtëzakonshme gjeostrategjike, me ndikim në botën arabe, i cili mund të luajë rol të rëndësishëm për njohjen e Kosovës nga shumë vende aziatike dhe afrikane.

Ahmed Fahmy Ahmed, kryetar i Këshillit Shura (Dhoma e Lartë - Këshilli Konsultativ) - Theksoi se populli i Egjiptit vlerëson lart patriotizmin e popullit të Kosovës dhe sakrificat e tij për lirinë e vendit. Ai u shpreh i bindur se populli i Egjiptit vazhdimisht do ta mbështesë Kosovën dhe popullin e saj. Theksoi nevojën për thellimin e marrëdhënieve ndërmjet vendit të tij dhe Kosovës dhe shprehu shpresën për njohjen e Kosovës nga Egjipti, në një kohë jo shumë të largët. Lidhur me bisedimet me Serbinë theksoi se është e rëndësishme që serbët t'i pranojnë dëmet që i kanë shkaktuar popullit të Kosovës, të kërkojnë falje dhe çështjet të zgjidhen në mënyrë të qetë dhe paqësore.

Skender Hyseni - Përgëzoi delegacionin për kthesën e madhe të "Pranverës arabe" dhe e njoftoi atë për angazhimet e tij rreth njohjeve që i ka pasur në cilësi të ministrit të parë të jashtëm, pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Njoftoi se në atë cilësi ka takuar dy herë ministrin e jashtëm të Egjiptit në Nju Jork dhe se në takimin e dytë nga ai kishte marrë premtimin se pas opinionit pozitiv të GJND-së, Egjipti do ta njihte Kosovën, por megjithatë ky premtim nuk u realizua. Kërkoj nga delegacioni që të ushtrojë ndikimin e tyre në njohjen sa më të shpejtë të Kosovës, në përkrahjen e plotë të saj dhe në komunikim intensiv e modern në mes të dy vendeve.

Emilija Rexhepi falënderoi delegacionin për vizitën që i ka bërë Kosovës duke cekur se Egjipti është një shtet shumë modern dhe i vjetër sa i përket historisë dhe arsimimit, por edhe të kulturës sonë islame. Theksoi se ndihet mirë për përkrahjen institucionale dhe pajtohet me z. Ahmed lidhur me vlerat e shoqërisë demokratike. Po qese ne të gjithë jemi së bashku, unik e solidarë tha se do të mund t'i ndërtojmë parimet demokratike dhe do t'i përmbushim qëllimet tona, në të mirë të të gjithë komuniteteve që jetojnë në Kosovë.

Albin Kurti falënderoi delegacionin për këtë takim të dobishëm në funksion të bashkëpunimit në mes të dy shteteve.

Takimi përfundoi në orën 14:35.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti